



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Primesha / Dorezuar Primesha/Prodato Receipt/Delivery	05.12.2022	2	viti god year
Organ /Bjesta Organ /Zjedritca Org /Unit	Pr Prof Pr Prof Prof No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kohësira Quantity
SKIMS/HCK	7679/2022		114

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.736/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malore Gashi - Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani - anëtarë, si dhe me Zyle Millaku Gojnovci- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.3103/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative të datës 31.10.2022, të pranuar me datë 04.11.2022 për shqyrtimin e ankesës me numër A.Nr.736/2019, të datës 26.11.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë:

kundër organit të punesimit Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore-Vërejtje me shkrim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 05.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i iniciuar me ankesën me numer A.nr.736/2019 të datës 26.11.2019 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ndaj ankueses e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, sipas Akt emërimit të datës 08.06.2018, në pozitën "Drejtores e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore", me datë 28.10.2019 Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin të Aviacionit Civil të Kosovës, i ka shqiptuar masë disiplinore-Vërejtje me shkrim, me arsyetimin se nuk ka zbatuar urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm me rastin e dhënies së përgjegjës së datës 16.10.2019 për Agjencinë Kundër Korrupsion.

Ankuesja e paknaqur me shqytimin e masës disiplinore „vërejtje me shkrim“ nga Drejtori i Përgjithshëm të datës 28.10.2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 26.11.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.12.2019 ka përcjell kërkesën për përgjigje në ankesë, tek Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës -ACC-së, ndersa Këshilli ka pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës me datë 06.12.2019, përgjigjen në ankesë me numër protokoll 5693/2019 me shkresat e bashkangjitura prej 1/45 faqe.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.12.2019, e ka njoftuar ankuesen se ankesa e saj e datës 26.11.2019, nuk mund të shqyrtohet për shkak se Këshilli ka qenë jo funksional dhe mungese të kourumit duke udhëzuar ankuesen që të ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me datës 31.10.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.3103/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e ankueses duke anuluar njoftimin e datës 11.12.2019 dhe ka obliguar Këshillin që brenda afatit ligjor të shqyrtoj ankesën ankueses të datës 26.11.2022 .

Administrimi i Provave: Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimi A.nr.3103/2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën A.Nr.736/2019 e parashtruar më datë 26.11.2019 me numër protokoll 5529/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shënimin Civil të Kosovës; Vërejtjes me shkrim të datës 28.10.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; Akte emërimit të datës 08.06.2018; Vendimi Nr.Ref:19/2019 të datës 17.07.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës ;E-mail i datës 08.11.2019 nga ankuesja drejtuar z. E-mail i datës 08.11.2019 nga hetimet@akk-ks.org; E-mail i ankueses i datës 31.10.2019 lidhur me pranimin e vërejtjes; E-mail i datës 17.10.2019 nga ankuesja për hetimet@akk-ks.org; E-mail i datës 16.10.2019 nga z. për ankuesen; E-mail i datës 16.10.2019 nga z. për ankuesen, kërkesë për dokumentacion; E-mail nga adresa:hetimet@akk-ks.org për ankuesen e datës 16.10.2019; Përgjigje ne ankesë e datës 06.12.2019; E-mail i datës 16.10.209 nga znj. drejtuar z. E-mail i datës 16.10.2019 Kërkesë për Dokumentacion nga hetimet@akk-ks.org, për ankuesen; E-mail i datës 16.10.2019 Kërkesë për Dokumentacion nga z. për ankuesen dhe znj. E-mail i datës 16.10.2019 Kërkesë për Dokumentacion nga hetimet@akk-ks.org; E-mail i datës 17.10.2019 nga ankuesja për hetimet@akk-ks.org, dhe z. Ftesë për raportim; E-mail i datës 16.11.2019 nga z. për ankuesen-ftesë për raportim; E-mail i datës 16.10.219 nga ankuesja drejtuar hetimet@akk-ks.org, z. duke bashkangjitur : AAC-Rregullore e brendshme 2013, AAC - Rregullore e brendshme 2011, AAC-Urdhër Nr.01-UA-2014, ACC-Urdhër Nr.01-2011 dhe Rregullore e brendshme e datës 17.01.2011 , Urdhër Nr.01-2012i datës 02.04.2012; E-mail i datës 16.10.2019 nga znj. për ankuesen dhe z. E-mail i datës 16.11.2019 nga ankuesja drejtuar znj. dhe z. Vendimi Nr.ref.19/2019 datës 17.07.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 15.03.2015 prej 1/7 faqe; Rregullorja për organizimin e brendshëm AAC-së i datës 09.07.209 prej 1/18 faqe bashkangjitur dhe organogramin; E-mail i datës 16.10.2019 nga z.. për ankuesen , znj. dhe z. kërkesë për dokumentacion; E-mail i datës 16.10.2019 nga ankuesja drejtuar z. znj dhe z. Kërkesë E-mail nga Këshilli drejtuar njësisë së personalit respektivisht znj lidhur me provat shtesë sipas Aktgjykimit të Gjykatës së datës 31.10.2022 që lidhet me çështjen juridike të ankueses; Përgjigje e datës 05.12.2022 nga Njësia e Personelit të AAC-së, sipas kërkesës së Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses *është bërë i pamundur, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se Vërejtja me shkrim e datës 28.10.2019 e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm, i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, është shqiptuar në kundërshtim me ligjslacionin në fuqi respektivisht për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale dhe procedurale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, dhe ka konstatuar se ndaj ankueses Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës si udhëheqes i drejteperdrejte i ka shqiptuar masë disiplinore „vërejtje me shkrim“ në bazë të nenit 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nën dyshimin se ankuesja ka bërë shkelje të lehtë të detyrave të punës gjegjësisht me arsyetimin se ankuesja nuk ka zbatuar urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm me rastin e dhënies së *përgjegjës së datës 16.10.2019 për Agjencinë Kundër Korrupsion.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që ka pranuar Aktgjykimin A.nr.3103/2019 të datës 31.10.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me qëllim të vendosjes në mënyrë sa më meritore për rastin e ankueses, më datë 02.12.2022 ka kërkuar informata zyrtare nga Zyra e Burimeve Njerëzore e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, dëshmi lidhur me shuarjen e masës disiplinore „Vërejtje me shkrim“ të datës 28.10.2019 të shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se masa disiplinore „Vërejtje me shkrim“ e datës 28.10.2019 e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës është fshirë nga dosja e personelit dhe regjistri përkates i SMBNJ-së duke bashkangjitur edhe Vendimin me numër protokollit 2021/BNJ/332 të datës 23.11.2021 të nxjerre nga Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës. Kete Vendim Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës e ka nxjerr sipas kërkeses se ankueses me të cilin masa disiplinore „Vërejtje“ e shqiptuar me datë 28.10.2019 nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës i është larguar nga dosja elektronike dhe fizike në pajtim me dispozitat e nenit 51 paragrafit 1, nenparagrafit 1,1 dhe paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenin 14 paragrafi 2 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinë dhe Ankesa Zyrtarëve Publik .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këtë rrethanë, ka konstatuar se meqenëse ankueses i është shuar respektivisht i është larguar nga dosja elektronike dhe fizike masa disiplinore „Vërejtje“ e datës 28.10.2019 e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, i cili fakt është dëshmuar edhe sipas Vendimit me numër protokollit 2021/BNJ/332 të datës 23.11.2021 të nxjerre nga Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, atëherë Kolegji konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur apo i kohë sepse me këtë rast nuk ka objekt të shqyrtimit, kësaj në pajtim me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”,* Kolegji për shqyrtimin dhe



vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e ankueses së datës 26.11.2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore „Vërejtjes me shkrim“ të datës 28.10.2019 të shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numer A.Nr.736/2019.

Zyle Millaku GOJNOVCI


Procesmbajtëse



Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës-AAC-së
- Udhëheqëses së Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës-AAC-së,
- Arkivit të KPMSHCK-së .

